

VENDIM
Nr. 109, datë 31.7.2012

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË METODOLOGJINË E LLOGARITJES SË DËMIT
EKONOMIK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51 pika 14 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.7.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e “CEZ Shpërndarje” dhe relacionin e përgatitur nga ana e drejtorive teknike për disa ndryshime në Metodologjinë e Llogaritjes së Dëmit Ekonomik,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në Metodologjinë e Llogaritjes së Dëmit Ekonomik (ndryshimet sipas tekstit bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani